



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

## PROJEKT VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

PËR

**MIRATIMIN E VLERAVE PËR SECILIN ELEMENT PËRBËRËS TË  
PAGËS BRUTO MUJORE TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT TË  
MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi” dhe të pikës 1, shkronja “a” dhe pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr. 152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave,

### VENDOSI:

1. Ky vendim ka për qëllim miratimin vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.
2. Elementet e pagës bruto mujore dhe vlerat për secilin element, janë si më poshtë vijon:
  - a) Paga për gradë, që përfaqëson nivelin e pagës së punonjësit, në përputhje me gradën që ka fituar brenda nivelit përkatës. Vlera e pagës për gradë përcaktohet në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
  - b) Shtesa për natyrë të veçantë pune, që u jepet punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, për natyrën e veçantë të punës e të

shërbimit që kryejnë, vlera e së cilës përcaktohet në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Shtesa për vjetërsi shërbimi, që është shtesa që përfiton punonjësi i Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, për çdo vit vjetërsi në shërbim, në masën 1 për qind për çdo vit, deri në 25 vjet. Kjo shtesë llogaritet mbi vlerën e pagës bazë të gradës “Asistent zjarrfikës”.

3. Për efekt të llogaritjes së shtesës për vjetërsi, vite shërbimi do të konsiderohen vitet e qëndrimit në gradë, të dokumentuara në librezën e punës apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, të çdo punonjësi, në strukturat e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Policisë së Burgjeve, Gardës së Republikës së Shqipërisë, Agjencisë së Mbikqyrjes Policore, Policisë së Shtetit si dhe në strukturat e Shërbimit Informativ të Shtetit.
4. Vitet që përjashtohen nga llogaritja e shtesës së vjetërsisë në shërbim, vetëm për efekt pagese, janë vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, vitet e punës si punonjës pa grada, vitet e shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit ushtarak të Ministrisë së Punëve të Brendshme e të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe periudhat e trajtimit me pagesë papunësie apo pagesë kalimtare.
5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2024, të përballohen nga fondi i kontingjencës për rritjen e pagave, sipas përcaktimeve në ligjin 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, në nivel qendror dhe në nivel vendor.
6. Vendimi nr.350, datë 19.4.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, i ndryshuar, shfuqizohet.
7. Ngarkohen, Ministria e Brendshme, Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, në nivel qendror, dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë strukturat përkatëse të këtij shërbimi, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2024.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

## Lidhja Nr. 1

**Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Shërbimit të  
Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin**

<b>Niveli</b>	<b>Grada</b>	<b>Paga bazë për gradë</b>	<b>Shtesa për natyrë të veçantë pune</b>
Niveli bazë	Asistent Zjarrfikës	60,000	7,000
	Zjarrfikës	65,000	8,000
	Kryezjarrfikës	70,000	8,000
Niveli i mesëm	Inspektor Zjarrfikës	75,000	6,000
	Kryeinspektor Zjarrfikës	85,000	6,000
	Komisar Zjarrfikës	105,000	6,000
Niveli i lartë	Drejtues Zjarrfikës	115,000	
	Drejtues i Parë Zjarrfikës	140,000	
Niveli madhor	Drejtues i Lartë Zjarrfikës	160,000	